




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN

VENDIM

Nr.7, datë 06.03.2023

PËR



**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR  
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK  
SHOQËRISË “EL-POWER” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman.

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik shoqërisë “El-Power”, sipas Kontratës me Nr. 222 Rep., Nr. 89 Kol., datë 14.01.2019 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Mullini 1 dhe 2” me kapacitet prodhues 1.480 MW” me vendndodhje në Përroin e Madh, Mullinit dhe Mollës Bashkia Kolonjë Qarku Korçë.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

**HEC Mullini 1**

Vendndodhja e veprës së marrjes 1/ burimi ujor Përroi i Madh

- X= 549447; Y= 4474863; Z=947 m.m.n.d. (KRGJSH)



- Prurja llogaritëse: 0.4 m<sup>3</sup>/s
- Prurja mesatare vjetore: 0.161 m<sup>3</sup>/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 0.038 m<sup>3</sup>/s
- Prurja ekologjike: 0.016 m<sup>3</sup>/s

Vendndodhja e veprës së marrjes 2/ burimi ujq Përroi i Mullinit

- X= 550750; Y= 4475674; Z=890 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 0.9 m<sup>3</sup>/s
- Prurja mesatare vjetore: 0.284 m<sup>3</sup>/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 0.284 m<sup>3</sup>/s
- Prurja ekologjike: 0.019 m<sup>3</sup>/s

Vendndodhja e godinës së Centralit

- X= 551159.47; Y= 4473975.62; Z=814 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja që shkarkohet: 1.3 m<sup>3</sup>/s
- Prodhimi vjetor i parashikuar: 2.566.599 kwh/vit
- Fuqia e instaluar: 960 kwh
- Vlera totale e investimit: 118,677,050 lekë pa TVSH.

### **HEC Mullini 2**

Vendndodhja e veprës së marrjes 1/ burimi ujq Përroi i Mullinit

- X= 549142; Y= 4476022; Z=979.2 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 0.41 m<sup>3</sup>/s
- Prurja mesatare vjetore: 0.140 m<sup>3</sup>/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 0.033 m<sup>3</sup>/s
- Prurja ekologjike: 0.007 m<sup>3</sup>/s

Vendndodhja e veprës së marrjes 2/ burimi ujq Përroi i Mollës

- X= 550213; Y= 4477040; Z= 977 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 0.34 m<sup>3</sup>/s
- Prurja mesatare vjetore: 0.143 m<sup>3</sup>/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 0.033 m<sup>3</sup>/s
- Prurja ekologjike: 0.0072 m<sup>3</sup>/s

Vendndodhja e godinës së Centralit

- X= 550739.78; Y= 4475668.99; Z= 894 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja që shkarkohet: 0.75 m<sup>3</sup>/s
- Prodhimi vjetor i parashikuar: 1.194.941 kwh/vit
- Fuqia e instaluar: 520 kwh
- Vlera totale e investimit: 70,046,507 lekë pa TVSH.

3. Zbatimi i kontratës nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.

- 
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

**KRYETARI I KBU SEMAN**

**LEFTER SHEHAJ**

